Në bazë të Konstatimit për gjendjen e paisjeve –linjës së prodhimit të Fabrikës për përpunimin e mjaltit"Golden Honey" Deçan, lëshuar nga Komisioni i Komunal themeluar enkas për këtë çështje, Vendimit të Komisionit Komunal për dhënien e pronave Komunale në shfrytëzim të dt.04.06.2018 nr.01-16013 dhe duke u mbështetë në nenin 55 pika 20 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kryetari i Komunës së Deçanit, me dt.04.06.2018 , merr këtë:

V E N D I M

MBI PRANIMIN E SHPENZIMEVE PËR SERVISIMIN E MAKINAVE-LINJËS SË PRODHIMIT TË FABRIKËS PËR PËRPUNIMIN E MJALTIT "GOLDEN HONEY" - DEÇAN

I. Pranohen shpenzimet për riparimin e makinave-Linjës së prodhimit të Fabrikës për Përpunimin e Mjaltit "Golden Honey" në Deçan, në vlerë prej 8,070.00 €, kurse pjesa tjeter e shpenzimeve që janë kryer rreth këtij servisimi nuk pranohen si shpenzime që do të kompenzohen nga Komuna.

II. Fabrika për përpunimin e Mjaltit është dhënë në shfrytëzim afatshkurtër me qera, me procedurë të rregullt ligjore, sipas ligjit në fuqi-Ligji nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, sipas të cilit Kompania fituese duhet t'i paguan Komunës qeranë mujore prej 1(një) € për m^2 apo qera mujore në total 600.00 € në muaj, ku shuma prej 8,070.00 €, e pranuar si shpenzim në këtë rast kompenzohet me kthyrje me qeranë mujore ndaj Komunës, që do të barazohet me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

III. Për realizimin e këtij vendimi do të kujdesen:Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim e KK Deçan.

IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

V. Me vendim njoftohen:
1.Pala,
2.Drejtoria kompetente komunale, dhe
3.Arhivi i KK Deçan.

02.Nr.
Dt.04.06.2018

Kryetari i Komunës:
Bashkim Ramosaj

DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT • OPŠTINA DEÇANE • DECANI MUNICIPALITY
Njesia Org. / Org. Jedinica / Org. Unit: E-kryetarit
Nr. Prot: / Br. Prot: / Prot. No.: 16024
Nr. i faqeve: / Br. Stranica: 02
Data: / Datum: / Date: 04.06.18